



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1034/ 7 prot.

Datë 28.04.2025

V E N D I M
Nr. 571/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:	Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lis Konstruksion” SHPK & “Murati” SHPK, në procedurën e prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-43772-04-04-2025, me objekt “Riaftësim strukturor i pallatit nr.167 ”Viko” lagjja 13, Plazh, Rruga Pavarësia”, me fond limit 168,410,054 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e dhjetë mijë e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 17.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
Ankimues:	Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lis Konstruksion” SHPK me NIPT K66613407H & “Murati” SHPK, me NIPT J66702413V dhe adresë: Lagjja “Minatori”, Rruga e Spitalit, Pallati nr. 12, Shk. 1, Kati 5, AP 15, Tiranë.
Autoriteti Kontraktor:	Bashkia Durrës, me adresë: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligji 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 të këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe ligjin nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.04.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-43772-04-04-2025, me objekt “Riaftësim strukturor i pallatit nr.167 ”Viko” lagja 13, Plazh, Rruga Pavarësia”, me fond limit 168,410,054 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e

dhjetë mijë e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 17.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 17.04.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, ku konstatohet se kanë shprehur interesin këta operatorë ekonomikë:

1. BOE “Desaret Company” Shpk & “Fled” Shpk & “Aurora Konstruksion” Shpk
2. OE “Ergi” Shpk
3. OE “Eurondërtimi 2000” Shpk
4. BOE “Liqeni VII” Shpk & “Ulza” Shpk
5. BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk
6. BOE “Rajli Ndërtim” Shpk & “Selami” Shpk

II.3. Në datën 17.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (short listing) ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--|--------------|
| 1. BOE Desaret Company Shpk & Fled Shpk & Aurora Konstruksion Shpk | Skualifikuar |
| 2. OE Ergi Shpk | Skualifikuar |
| 3. OE Eurondërtimi 2000 Shpk | Skualifikuar |
| 4. BOE Liqeni VII Shpk & Ulza Shpk | Skualifikuar |
| 5. BOE Lis Konstruksion Shpk & Murati Shpk | Skualifikuar |
| 6. BOE Rajli Ndërtim Shpk & Selami Shpk | Kualifikuar |

II.4. Në datën 22.04.2025, BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk ka paraqitur ankesë në sistemin elektronik të ankesave njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik dhe autoritet kontraktor, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tyre ekonomike, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 23.04.2025 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 539/2025, vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

1. *Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-43772-04-04-2025, me objekt: “Riaftësim strukturor i pallatit nr.167” Viko” lagjja 13, Plazh, Rruga Pavarësia”, me fond limit 168,410,054 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e dhjetë mijë e pesëdhjetë e katër) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 17.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.*
2. *Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet*

përkatëse mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, si dhe të gjitha materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse.

3. *I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se dita e nesërme e punës nga data e marrjes së këtij vendimi, dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumenteve me numrin e fletëve përkatëse.*
4. *Për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, komunikimi dhe dërgimi i dokumentacionit të kërkuar më sipër, do të bëhet në mënyrë elektronike në adresën Kpp_info@kpp.gov.al.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6. Komisioni i Prokurimit Publik, në përputhje me Ligjin nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, vendimin e mësipërm e ia dërgoi autoriteti kontraktor nëpërmjet postës elektronike në datë 24.04.2025, në adresat e emailit të publikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Autoriteti kontraktor, është njoftuar nga Komisioni i Prokurimit Publik për dorëzimin e dokumentacionit të sipërpërmendur, nëpërmjet postës elektronike të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, dhe ka dërguar informacionin e kërkuar të përcaktuar në vendimin Nr.539/2025, datë 23.04.2025 të KPP, të protokolluar me tonin me nr. 1034/4 prot., datë 25.04.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se procedura e shqyrtimit administrativ të ankesës së operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik rregullohet nga ligji nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

III.1.1. Neni 42 pika 10 i ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, parashikon shprehimisht se: “10. Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për për zgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të këtij akti. Për efekt kohe, komunikimi midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet nëpërmjet e-mail-it zyrtar. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.”

III.1.2. Lidhur me pretendimin e BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me argumentimin se: “Kontrata e qerasë nr. repertori 10143 nr. koleksioni 6759 date 16.10.2021 midis L. B. DHE “EUROALB” shpk (LIS KONTRUKSION) për kamionçinën me targa AAxxxxMR kapaciteti 3,5 ton i mungon përcaktimi i objekti sipas DST (për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve gjithashtu mungon certifikata e transportit të mallrave e cila specifikon nëse është për llogari të vet apo për të tretë dhe me qera.

Kontrata e qerasë nr. repertori 4316 dhe nr. koleksioni 3269 data 15.04.2025 midis “B. K.” DHE “LIS KONSTRUKSION” shpk për objektin vinç kullë nuk është objekti i kontratës sipas DST (për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Kontrata e qerasë me nr. repertori 2981 nr. koleksioni 2349 datë 24.05.2023 midis shoqërisë “CO-B.” shpk dhe “LIS KONSTRUKSION” shpk për autobetonjeret me targa AAxxxxAE, AAxxxxNR i mungon objekti sipas DST (për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve). gjithashtu autobetonjerja me targa aaxxxxnr është marrë me qera dhe nga “Liqeni i VII” shpk (Kontrata e qerasë me nr. repertori 13326 dhe nr. koleksioni 5406 datë 13.07.2023 lidhur ndërmjet “CO-B.” shpk dhe “LIQENI VII” për mjetin autobetonjere AAxxxx NR).

Kontrata e qerase nr. repertori 12870 dhe nr. koleksioni 8631 datë 18.11.2023 “K. D.” shpk DHE “LIS KONSTRUKSION” shpk Për mjetet minieskavator me zinxhirë gome, kamionçinë me targa ABxxxxKA, AEMTxxxxx, ABxxxKR, AAxxxJA, AAxxxxKK, i mungon objekti sipas DST (për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve), Gjithashtu automjetet janë jashtë kapacitetit të kërkuar.

Kontrata e qerase nr. repertori 1186 dhe nr. koleksioni 916 datë 19.02.2025 ndërmjet shoqërisë “CO-B.” shpk dhe “LIS KONSTRUKSION” shpk DR xxxE i mungon objekti sipas DST (për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve).

Faturat e paraqitura për zërin armatur druri (betoforma) nga shoqëria “MURATI” shpk sasitë e paraqitura xxx metër kub dhe nuk ka konvertim në metër katror siç kërkohet në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.3. Në shtojcën 15/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.7. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Automjet vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5 -18 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
Automjet vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
Automjet me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Automjet me Vinç kulle me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Minieskavator me zinxhirë deri 3 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Mini Fadromë	1 copë	Në pronësi ose me qera
Autobot uji (kapaciteti minimal 5000 litra)	1 copë	Në pronësi ose me qera
Betoniëre kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
Autobetoniëre	2 copë	Në pronësi ose me qera
Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
Vibrator thellësie	1 copë	Në pronësi ose me qera
Pompe Suvatimi	1 copë	Në pronësi ose me qera
Depozitë uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	1 copë	Në pronësi ose me qera
Moto pompe uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
Armatur druri (Betoforma)	1000 m ²	Në pronësi ose me qera
Skeleri + Rrjet plastike për mbrojtje në punë	6000 m ²	Në pronësi ose me qera

Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:

- certifikatën e pronësisë;
- lejen e qarkullimit;
- certifikatën e kontrollit teknik;
- siguracionin;
- certifikate transporti lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe fotot përkatëse;

ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve

- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- *kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.*
- *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*
- *Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nga informacioni i dërguar me postë elektronike nga ana e autoritetit kontraktor rezulton, se BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK, me datë 17.04.2025.

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Murati” SHPK, me datë 17.04.2025.

-Kontratë bashkëpunimi me datë 17.04.2025 e lidhur ndërmjet shoqërive “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk.

-Kontratë qiraje me nr. Rep 101143 nr. Kol 6759 datë 16.10.2021 lidhur midis shoqërive “Lis Konstruksion” SHPK dhe Z. L. B., me objekt qiradhënisi i jep me qera qiramarrësit mjetin kamionçinë me targë AA xxx MR, me afat 16.10.2021-16.10.2026;

-Kontratë qiraje me nr. Rep 4316 nr. Kol 3269 datë 15.04.2025 lidhur midis shoqërive “Lis Konstruksion” SHPK dhe shoqëria “B. K.” Shpk, me objekt qiradhënisi i jep me qera qiramarrësit mjetin Vinc Kullë lloji CBRxxxx, me afat 15.04.2025-15.04.2030;

-Kontratë qiraje me nr. Rep 2981 nr. Kol 2349 datë 24.05.2023 lidhur midis shoqërive “Lis Konstruksion” SHPK dhe shoqëria “Co-B.” Shpk, me objekt qiradhënisi i jep me qera qiramarrësit mjetin autobetonierë me targa AAxxxxNR, me targa AAxxxxxAE, me afat 2 vjeçar;

-Kontratë qiraje me nr. Rep 12870 nr. Kol 8631 datë 18.11.2023 lidhur midis shoqërive “Lis Konstruksion” SHPK dhe shoqëria “K. D.” Shpk, me objekt qiradhënisi i jep me qera qiramarrësit mjetin minieskavator me zinxhirë gome, Kamion me vinç me targa AA xxxxYI, me afat 18.11.2023-17.11.2028;

-Kontratë qiraje me nr. Rep 1186 nr. Kol 916 datë 19.02.2025 lidhur midis shoqërive “Lis Konstruksion” SHPK dhe shoqëria “Co B.” Shpk, me objekt qiradhënisi i jep me qera qiramarrësit mjetin Autopompë betoni me targa DRxxxE, me afat 2 vjeçar;

-Fatura tatimore të OE “Lis Konstruksion” SHPK për lëndë drusore;

-Fatura tatimore të OE “Murati” SHPK për lëndë drusore;

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.7. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.8. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.9. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.10 Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik ka ngarkuar në SPE shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” si dhe ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterëve të kualifikimit të vetëdeklaruar në shtojcën 8, ku deklaroi mjetet dhe makineritë, referuar kriterit të parashikuar në pikën 2.3.7 të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik ka deklaruar në shtojcë (Llojin e mjetit, Targën e mjetit, Nr. Lejes qarkullimit të mjetit, Nr. Shasisë së mjetit, Nr. Kontratës Qirasë, Afati i Kontratës Qerasë, duke evdidentuar:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Automjet me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	1 copë	me qera me kontratë me NR 10143 REP NR 6759 KOL, afati 16.10.2021 16.10.2026, mjeti me targa AA xxxx MR,

Automjet me Vinç kulle me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton	1 copë	me qera, kontratë me NR 4316 REP NR. 3269 KOL, me afat 15.04.2025 15.04.2030, Fat nr. 220, dt. 30.08.2024
Minieskavator me zinxhirë deri 3 ton	1 copë	me qera, kontratë me NR. 12870 REP NR. 8631 KOL 52418, dt 09.05.2021, afati 18.11.2023 17.11.2028
Autobetoniere	2 copë	me qera, me kontratë NR 2981 REP NR 2349 KOL, me afat 24.05.2023 24.05.2025, mjeti me targa AA xxx AE, AA xxx SR, AA xxxNR
Autopompë betoni	1 copë	me qera, kontratë me NR 1186 REP NR 916 KOL, afat 19.02.2025 19.02.2027,
Armatur druri (Betoforma)	1000 m ²	Pranësi me fatura tatimore Fat nr. 112 dt. 20.02.2019 Fat nr. 103 dt, 19.02.2019, Fat nr. 117 dt, 21.02.2019 Fat nr. 82 dt, 09.03.2019 Fat nr. 67 dt, 01.03.2019 Fat nr. 80 dt, 08.03.2019 Fat nr. 81 dt, 08.03.2019, Fat nr. 65 dt, 28.02.2018 Fat nr. 66 dt 28.02.2018 Fat nr. 57 dt, 27.02.2018 Fat nr. 58 dt, 27.02.2018 Fat nr. 67 dt, 28.02.2018, Murati Shpk Fat nr. 221, dt. 22.04.2017, Fat nr. 245, dt. 26.04.2017

III.1.11. Referuar sa më sipër KPP gjykon, se anëtari i BOE “Lis Konstruksion” SHPK në lidhje me përmbushjen e disponimit të mjeteve, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Spe edhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor rezulton se e ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.7. Konkretisht, në rastin konkret, Komisioni sqaron se:

-Për sa i përket mjeteve të pretenduara nga BOE ankimes që nuk disponojnë dokumentacionin e rregullt sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në lidhje me arsyen e skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Oferta, që *“i mungon përcaktimi i objekti sipas DST (për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të **përfshijë objektin përkatës** dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve”*, për mjetet e sipërcituara, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit nga KVO nuk qëndron për arsye se për autoritetin kontraktor si përfitues i punës, e rëndësishme është që në momentin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave të sigurohet që operatorët ekonomikë kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme të cilat i japin garancinë që puna do të përmbushet me cilësi dhe në kohë, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë rast nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga OE, konkretisht kontratat e qerasë ne secilën prej tyre ne dispozitën përkatëse mbi objektin e kontratës si dhe kohëzgjatjen ato japin informacion mbi posedimin e mjeteve në një nga format e parashikuara nga ligji dhe nga kriteri konkret (me kontratë qiraje) si dhe mbi kohën e disponimit të tyre gjatë ekzekutimit të kontratës objekt prokurimi, pasi nene përkatëse mbi kohëzgjatjen e kontratave në vitet 2026 (16.10.2026)-2030, çka mbulon edhe afatin e kryerjes së punëve objekt i procedurës së ankimit në bazë të së cilës do të lidhet kontrata përkatëse.

-në lidhje me mjetin e kërkuar sipas kriterit 2.3.7 Automjet me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton, 1 copë, BOE e plotëson me disponimin e mjetit me targa AAxxxXA, të shoqëruar me dokumentacionin sipas kriterit të kualifikimit teknik;

-në lidhje me mjetin e kërkuar sipas kriterit 2.3.7 Autobetoniere 2 copë, BOE e plotëson këtë kërkesë me anë të kontratës NR. 2981 REP NR .2349 KOL, me afat 24.05.2023-24.05.2025, mjeti me targa AA xxx AE, AA xxx SR, AA xxx NR, ku edhe pse mjeti me targa AA xxx NR, është i deklaruar edhe nga OE “Liqeni VII” shpk, ofertues dhe pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimit objekt shqyrtimi, KPP evidenton se autoriteti ka kërkuar disponimin e 2 copë mjeteve të tilla që sipas kësaj kontrate qiraje janë marrë 3 copë mjete llojit autobetoniere, 2 prej të cilave përmbushin kriterin e DT.

-në lidhje me mjetet e pretenduara nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si *kamionçinë me targa ABxxxKA, AEMTxx, ABxxxxKR, AAxxxJA, AAxxxKK, automjetet janë jashtë kapacitetit të kërkuar*, KPP pas shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e BOE, evidentoi që mjetet e pretenduara nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nuk janë të deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të OE “Lis Konstruksion” SHPK. Në këtë rast, kriteri i kualifikimit në procedurat e rindërtimit nuk përmbushet me Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe informacionit të dërguar të autoritetit kontraktor, KPP konstaton se, automjetet e sipërcituara kanë respektivisht tonazhin: ABxxxKR – 25,800 kg, AAxxxJA- 25,350 kg dhe AAxxxKK -25,650 kg, duke e përmbushur dhe e tejkaluar tonazhin dhe sasi të copë të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Për më tepër, OE “Lis Konstruksion” shpk ka paraqitur dokumentacionin sipas kriterit 2.3.7 për automjetet që ka në pronësi me targa ABxxxAY me tonazh 17,500 kg dhe ABxxxSU me tonazh 16,405 kg, në përmbushje të 2 copë automjete me kapacitet mbajtës 7.5-18 ton.

-Ndërsa në lidhje me arsyen e skualifikimit të OE “Murati” SHPK, se *Faturat e paraqitura për zërin armaturë druri (betoforma) nga shoqëria “MURATI” shpk sasi të paraqitura 11 metër kub dhe nuk ka konvertim në metër katror siç kërkohet në DST*, Komisioni sqaron se në kushtet kur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka paqartësi dhe nuk arrin dot të bëjë konvertimin e 1 m3 betoforme në 1 m2 betoforme, duhet t’i kërkojë sqarime ofertuesit, pasi në kushtet kur nuk është i qartë, nuk mund të referojë një arsye skualifikimi të tillë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ky i fundit si edhe nga informacioni i dhënë nga autoriteti kontraktor në lidhje disponimin e mjeteve në përmbushje të kriterit 2.3.7 të DT, Komisioni evidentoi se BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk ka paraqitur një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të bëjë deklarimin e adresës së saktë të vendndodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre. KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur nga BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk, ka provuar se disponon mjetet e kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimet e BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk, qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligji 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 të këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42 e vijues Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë

Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk, për procedurën e prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-43772-04-04-2025, me objekt “Riaftësim strukturor i pallatit nr.167 ”Viko” lagja 13, Plazh, Rruga “Pavarësia”, me fond limit 168,410,054 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e dhjetë mijë e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 17.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Lis Konstruksion” Shpk & “Murati” Shpk.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

